



Inclusion of Roma and Migrants in Schools  
Trainings, Open Discussions  
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

## RoMigSc – Raport përmbledhës – Përmbledhje ekzekutive dhe mësimet për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

### Përgaditur nga:

- Veli Kreci
- Merita Zulfiu Alili
- Besa Kadriu

### Rreth projektit:

Qëllimi kryesor i projektit RoMigSc është të mbështesë një integrim më të mirë të fëmijëve romë dhe migrues në arsim, përmes aktiviteteve të ndryshme që nxisin zhvillimin e politikave inovative, dialogun dhe zbatimin e politikave, si dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve .

Maqedonia ka ofruar numra të migrantëve që largohen si dhe të popullatës së emigrantëve dhe nuk ka pasur të bëjë me trajtimin e migrantëve që vijnë. Duke pasur parasysh faktin se Maqedonia është vend tranzit në rrugëtim, rruga e Ballkanit - një ndalesë tranzitore e një krize të emigrantëve të kohëve të fundit, nuk janë zhvilluar politika të posaçme arsimore lidhur me fëmijët migrues.

Sa i përket fëmijëve romë, ku regjistrimi në shkollat në të gjitha nivelet e arsimit është 20-30% më e ulët se në mesin e fëmijëve jo-romë dhe shkalla e braktisjes së fëmijëve është dy herë më e lartë, strategjitë më efektive të përfshirjes në shkollat janë thelbësore për efikasitetin në përfshirjen sociale dhe harmoninë në shoqëri.

Arsimi (mësuesit e mirë dhe shkollat e mira) është vendimtar për integrimin e suksesshëm të emigrantëve në shoqëri. Për më tepër diversiteti (shumëkulturore), është një mundësi për t'i bërë shkollat më gjithëpërfshirëse, kreative dhe me mendje të hapur.

### Qëllimet e Projektit:

Projekti, i cili financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Erasmus +, synon të kontribuojë në drejtim të

- krijimit të mjediseve mësimore gjithëpërfshirëse dhe demokratike.
- inkurajimit të pjesëmarrjes së të rinjve, zhvillimit të praktikave të përfshirjes dhe shpërndarjes për të rinjtë.
- parandalimit dhe luftimit të çdo forme diskriminimi dhe segregimi në arsim.
- nxitjes së mirëkuptimit të ndërsjellë dhe respektit midis njerëzve.
- rritjes së cilësisë së aktiviteteve të të mësuarit joformal, praktikave të punës së të rinjve dhe vullnetarizmit.

Kjo arrihet nëpërmes një numri aktivitetsesh kyçe, si: Studimi Fillestar, Trajnimi për Vullnetarët, Aktiviteti i Vullnetarizmit, Platforma Elektronike për përfshirjen në shkollat dhe tema ndërkulturore, Trajnimi për mësime të ndryshme dhe Seminaret kombëtare për aktorë të ndryshëm.



Inclusion of Roma and Migrants in Schools  
Trainings, Open Discussions  
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

Përmbledhja e raportit të sintezës së studimit fillestar në fjalë shenjon dhe diskuton rëndësinë e gjetjeve të përgjithshme në të gjitha vendet partnere, përfshirë rekomandimet e politikave, për situatën në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Një përmbledhje paraprake i përfshinte disa përfundime kryesore të studimit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Raportet e plota, të cilat sigurojnë informacionin për përmbledhjet, janë në dispozicion përmes faqes së internetit të projektit.

Gjetjet kryesore dhe rekomandimet e politikave nga studimi i literaturës relevante, praktikat e mira si dhe diskutimi i temës me më shumë se 50 informatorë kryesorë (praktikantë nga shkollat, administratat përkatëse, punonjësit socialë dhe stafi vullnetar organizues) në Slloveni, Gjermani, IRJM, Itali, Spanjë dhe Itali janë:

### **Ngasjmëritë e situatave të vendeve partner dhe qasjet e politikave**

**Aktualisht, asnjë nga vendet partnere nuk ka një sistem arsimor plotësisht të aftë për të siguruar pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të migrantëve, refugjatëve dhe romëve sa i përket rezultateve.**

Derisa ligjet dhe rregulloret zyrtare e pranojnë parimin e një shoqërie multikulturore ose së paku bashkëjetesën ndërkulturore, gjendja faktike është ende në shënjestër të një auditori të nxënësve që është konceptuar si një familje homogjene nacionale, nëse jo rajonale, e bardhë, "standarde" funksionale për mbështetjen e suksesit arsimor të nxënësit si dhe socializimin e tij / saj themelor. Nevojat e nxënësve "jo-standardë" shpeshherë perceptohen si një "devijim" nga ajo që duhet "të jetë" në vend të pikës fillestare të koncepteve të përshtatshme arsimore.

### **Rrjedha kryesore e reformës aktuale**

Pavarësisht nga kufizimet sistematike (orientimi, modelet mendore, financimi), ekziston një nivel i lartë angazhimi i shkollave, mësuesve dhe vullnetarëve, si dhe disa politika të vlefshme që mund të jenë pjesë e zgjidhjeve më sistematike në të ardhmen. Në të gjitha vendet partnere masa kryesore për integrimin e fëmijëve në shkolla përfshin periudhat e tranzicionit për një numër të caktuar të viteve, të cilat përbëhen nga ofertat e mësimi të gjuhëve dhe një gradim disi fleksibël të studentëve. Në të gjitha vendet e studiuara, trajnimi i vazhdueshëm formal dhe joformal i mësuesve në përgjithësi, por veçanërisht në trajtimin e diversitetit, raportohet të jetë i dobët dhe i fragmentuar. Shpesh mësuesit punojnë me burime tashmë të ngarkuara (të tilla si një raport i lartë student / mësues), duke lënë vetëm hapësirë minimale për aktivitete "shtesë". Prandaj iniciativat si zhvillimi i aktiviteteve shkollore në shkollë përmenden nga të gjitha vendet partnere, por mbizotëron një vlerësim skeptik i tërësisë dhe efektivitetit të iniciativave të tilla.



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

Në të gjitha vendet e studiuara, gjendja sociale e prindërve është raportuar të jetë një faktor i fortë përcaktues i suksesit shkollor tek fëmijët. Kjo është e vërtetë për të gjitha popullatat migruese, sikur dhe për romët. Sistemet shkollore në asnjë rast nuk kanë qenë në gjendje të kompensojnë plotësisht situatat e pafavorizuara të nxënësve në familjet e tyre.

Ekziston një konsensus i gjerë midis të gjitha vendeve të përfshira, që vetëm një qasje holistike, e cila përfshin masa për stabilizimin social të prindërve, përmirësimin e mundësive për punësim dhe kushte më të mira pune, strehim të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm, zhvillim të komunitetit dhe lagjes, udhëzime dhe konsulencë dhe një volum i mjaftueshëm, konsistencë dhe një kohëzgjatje e masave, mund të përmirësojë pozitivisht situatën. Në të gjitha rastet kërkohet një qasje e më shumë palëve, përkatësisht një rrjetëzim më i mirë dhe bashkëpunim ndërmjet aktorëve në përgjegjësi të ndryshme ligjore dhe statutore, sipas një koncepti të përgjithshëm të dakorduar.

Në vendet si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, shoqëria multikulturore me specifikat e saj, bashkëjetesa e grupeve të ndryshme etnike nëpërmjet edukimit shumëgjuhësh në moshat e hershme të shkollimit, mirëkuptimit dhe të jetuarit në mjedisin e dallimeve kulturore ka qenë sfida kryesore në hartimin e sistemit të suksesshëm shkollor në arritjen e kohezionit social. Brenda këtij sistemi të shkollimit, interesi i veçantë i integritetit të grupeve sociale të pafavorizuara, kërkon iniciativë shtesë të mbështetura nga përfaqësuesit vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

### **Roli i shkollave**

Për shkak se shkollat, për shkak të pjesëmarrjes së detyrueshme universale për fëmijët, janë një pikë kontakti universale për organizatat shtetërore dhe shoqërore në tërësi, ato potencialisht mund të jenë një qendër për qasje të tilla holistike ose të paktën një pjesë e rëndësishme e tyre.

### **Vullnetarizmi i Fortë**

Në të gjitha vendet partnere, vullnetarizmi luan një rol të fortë dhe pozitiv. Ndërsa në vende si Italia, Spanja, Gjermania dhe Sllovenia ekziston një traditë e fortë e pjesërisht e bazuar në besim (p.sh. Caritas dhe organizata të tjera katolike si dhe homologët e tyre protestantë) dhe angazhimi vullnetar në kujdesin social në tërësi, në të gjitha vendet partnere iniciativat e reja iu shtohen atyre tradicionale.

Pothuajse kudo partnerët vlerësojnë se sistemi formal i shtetit do të ishte i pamjaftueshëm për t'u përballur me sfidat dhe se puna vullnetare nuk lejon që sistemi të bjerë. Shumë nga iniciativat tregojnë për risitë që gjithashtu duhet të miratohen nga sistemi i rregullt, siç janë mundësitë e zgjeruara të mësimin të gjuhës, komunikimi dhe të mësuarit social, puna e përgjithshme sociale dhe organizimi i komunitetit.

Nga analiza e kësaj shtate partnerët kanë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet e politikave të cilat duhen ndjekur.

Bazuar në këto gjetje, parimet e mëposhtme do të përdoren për hartimin e konceptit të përgjithshëm për mësimdhënësin dhe trajnimin vullnetar në kuadër të projektit.



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

## Parimet e Përgjithshme të Intervenimeve të RoMigSc

- Mësimdhënësi, si dhe trajnimi vullnetar duhet të bazohen në të kuptuarit se migrimi është një realitet dhe duhet pranuar si një situatë standarde në një shoqëri transnacionale.
- Të jesh i dobishëm për popullsinë faktike në migracion dhe shoqërinë transnacionale, duhet të pranohet si misioni i përgjithshëm dhe thelbi i profesionalizmit për shkollat dhe mësuesit individualë.
  - "Përfshirja në diversitet" brenda kuadrit të të drejtave individuale demokratike individuale dhe qytetare në kontrast me "integrimin" në një "kulturë" të presupozuar nikoqire, duhet të përdoret si një koncept kornizë për një "pedagogji emigracioni të azhurnuar" (Mecheril) , të cilat mund të jenë të dobishme gjithashtu për të udhëhequr arsimin në një shoqëri transnacionale.
- Pranimi i diversitetit është pranimi i dallimeve individuale dhe jo përcaktimi i individëve me përcaktimin e tyre të supozuar sipas përkatësisë kulturore ose kombëtare.
- Puna me diversitetin në arsim duhet të shmangë "tjetërsimin" e individëve për shkak të prapavijës ose "identitetit" të supozuar.
- Nevojat praktike për zhvillimin e aftësive që janë të dobishme në shoqërinë aktuale nikoqire, duhet të kombinohen dhe të balancohen me zhvillimin e kompetencave që do të jenë të dobishme në vendin e origjinës, sikur edhe në tërë Europën. Modele si "International Schools", të cilat përdoren gjerësisht nga ekspertë ndërkombëtarë me të ardhura të larta dhe shumë të lëvizshëm për edukimin e fëmijëve të tyre, mund të japin disa njohuri në kuadrin e një edukimi me një perspektivë ndërkombëtare.
  - Potenciali i medias digjitale për mësimdhënien dhe vlefshmërinë e kompetencave në një mjedis mësimor shumëvjeçar dhe ndërkombëtar duhet të përdoret më gjerësisht.
  - Kompetencat për një shoqëri migracioni nuk mund të zhvillohen vetëm në nivelin e kompetencave individuale të mësimdhënësve.
  - Zhvillimi i kompetencës së mësuesve duhet të jetë pjesë e shkollës, sistemit arsimor dhe zhvillimit të përgjithshëm të sistemit shoqëror. Për këtë arsye, kompetenca për pjesëmarrje në zhvillimin e shkollës dhe sistemit duhet të jetë pjesë e zhvillimit të kompetencës së mësimdhënësve.
  - Evropa karakterizohet nga një evolucion dinamik i shoqërive dhe prandaj edhe misioni dhe metodologjia e arsimit po ndryshon. Sistemi arsimor duhet të reformohet vazhdimisht.
  - Trajnimi i mësimdhënësve nuk është një periudhë e vetme, por mësimi i mësuesve është mësimi gjatë gjithë jetës. Vëmendje dhe burime të mjaftueshme duhet të përdoren për këtë mësim dhe reflektim të praktikës.



Inclusion of Roma and Migrants in Schools  
Trainings, Open Discussions  
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

- Mësimi i kompetencave adekuate nuk mund të kufizohet vetëm në njohuri, por duhet të përfshij përvojën aktuale të reflektuar në mjedise të ndryshme kombëtare, kulturore dhe shoqërore.
- Praktikat e mira ndërkombëtare duhet jo vetëm të komunikohen, por të kenë përjetohen.
- Kompetencat e mësimdhënësve dhe vullnetarëve mund të përcaktohen nga njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe praktikat (për konceptin kornizë shih lit. e cituar në raportin kombëtar Gjermani, SVR Lehrerbildung 2016, përmbajtjen e artikujve të listuara më poshtë përshtatur dhe zgjeruar nga partnerët RoMigSc), të cilat duhet të të zhvillohen.

Disa pika kyçe që janë identifikuar në literaturë dhe informatat kyçe të informatorit si veçanërisht relevante përfshijnë:

Dije:

- Fakti i shoqërisë migreuese
- konceptet e diversitetit, multikulturalitetit, transnacionalitetit, integritit, modeleve të racizmit (tjetërsimit, biologjisë etj.), Të drejtave individuale qytetare dhe vlerave demokratike
- Ndërgjegjësimi për ndikimin e standardeve gjuhësore për performancën në të gjitha lëndët
- Metodatat e përdorimit të niveleve të përshtatshme gjuhësore (aftësia për të komunikuar qartë me grupet e ndryshme të synuara)
- ndryshimi midis gjuhës së përditshme dhe gjuhës arsimore
- Ndërgjegjësimi për parakushtet gjuhësore dhe kompetencat e përgjithshme të nxënësve
- njohuri se si mund të transferohen kompetencat nga një kontekst tjetër gjuhësor
- njohuri themelore mbi kulturat e origjinës, feve dhe traditave (për të ndihmuar kuptueshmërinë), ndërgjegjësimin për rrezikun e "tjetërsimit" (përcaktimi dhe veçimi i individëve sipas sfondit të tyre "kulturor")
- Njohuri për faktorët e diskriminimit dhe rreziqeve, ndërgjegjësim mbi gjendjen e prindërve, modelet e riprodhimit ekonomik dhe shoqëror dhe shmangien e stereotipeve negative
- njohuri të koncepteve të diagnostikimit të kompetencave, të fokusuara në identifikimin e fuqive dhe potencialit
- praktika dhe shembuj të mirë të mbështetjes së gjuhës, zhvillimit të shkollës, koordinimit

Shkathtësi:

- analizë e parakushteve për mësim
- Identifikimi i talenteve dhe potencialit
- aftësi komunikimi
- aftësi për ndërtimin e besimit
- shkathtësitë e bashkëpunimit
- mësimdhënien dhe zhvillimin e gjuhës së vendit nikoqir në të gjitha lëndët në mënyrë motivuese
- fleksibilitet
- përshtatje
- Aftësia për të reaguar ndaj parakushteve të ndryshme të të mësuarit, nëpërmjet rrugëve të përshtatura të qasjes në mundësitë e të nxënësve, nëpërmjet strukturave fleksibël, përmes



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation – Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

mediave të diferencuara, aranzhimeve individuale të mësimit dhe mbështetjes individuale (në klasë dhe nivel shkollor)

- Përdorimi i medias digjitale për të individualizuar përmbajtjen e mësimit, shpejtësinë dhe metodologjinë, duke përfshirë sigurimin e mjeteve shumëgjuhëshe të të mësuarit dhe të mësuarit e vlefshmërisë së rezultateve
- aftësi drejtuese

Qasje:

- realizëm (pranimi i asaj që është, jo i asaj çfarë duhet të jetë) ndjeshmëri
- pozitivizëm
- Orientimi për potencialin, jo mangësinë
- pranimi i diversitetit si fakt e jo si barrë
- Hapja pedagogjike dhe kurioziteti
- Empatia me çdo fëmijë
- durimi
- vlerësimi i aftësive dhe kompetencave të nxënësve nga të gjitha prejardhjet

Praktikimi:

- marja pjesë aktivisht në zhvillimin e shkollës për të zhvilluar kompetencat dhe praktikat e diversitetit
- ngritja për të gjithë studentët, jo vetëm studentët në "shumicë"
- Mbështetja e kompetencës gjuhësore në gjuhën origjinale, gjuhën e vendit pritës dhe gjuhën e komunikimit ndërkombëtar të të gjithë nxënësve me ose pa sfond migrimi gjatë gjithë karrierës shkollore
- Përdorimi i veglave të diagnostikimit gjuhësor
- Integrimi i përvojave jo vetëm të familjeve standarde të vendit nikoqir, por përvoja të ndryshme në materialet e mësimdhënies dhe mësimit
- Marja pjesë në trajnime dhe reflektim aktiv të praktikës
- Shmangja e "tjetërsimit" (etiketimit, stereotipizimit)
- Përfshirja e diversitetit të ndryshëm dhe talentit të stafit mësimdhënës
- përdorni i diagnostifikimit të pikave të forta individuale
- njohja dhe puna me vullnetarë dhe organizata relevante
- Ndërtimi i njohurive dhe rrjetit të aktorëve relevantë për tranzicion (persona në institucione relevante, kompani, OJQ mbështetëse, etj.)
- Përdornimi i mediave të shumëfishta për mësim dhe mësimdhënie

Mësimdhënësit duhet të njohin dhe të trajnohen në koncepte të përgjithshme në të cilat duhet të marrin pjesë mësimdhënësit dhe vullnetarët, bazuar në kompetenca të tilla si:

- Zhvillimi i shkollës: zbatimi i diversitetit në nivel shkolle
- reflektimi i vazhdueshëm i nevojave arsimore dhe praktikave të mira aktuale
- Zhvillimi dhe përdorimi i një bagazhi të materialeve që duhet të integrohen në trajnim dhe mbikëqyrjen kolegjiale
- shkëmbimi ndër-shkollor, shkëmbimi me organizatat përkatëse, veçanërisht puna sociale, etj.
- Programet ndërkombëtare të shkëmbimit
- Përvojat e veta të interkulturalitetit (puna dhe studimi jashtë vendit)



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation – Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2016-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

- Marja pjesë në konkurset relevante, rrjetet shkollore, skemat e auditimit për të motivuar dhe duke përcaktuar ndryshimet dhe zhvillimin e synuar

Vullnetarët:

Pjesa më e madhe e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, si dhe udhëzimeve për praktikën e përshkruar për mësuesit, zbatohen edhe për vullnetarët.

Rekomandime për politika

Politika e Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare më së fundi është sintetizuar në dokumentin "Përfundimet e Këshillit dhe të përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare, të mbledhura në Këshill, mbi përfshirjen në diversitet për të arritur një arsimim me cilësi të lartë për të gjithë" (2017 / C 62/02) Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 25.2.2017, [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2017:062:FULL & from = EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2017:062:FULL&from=EN)). Kapitulli në vijim i referohet rekomandimeve të theksuara në 15 paragrafë individualë, si C 1, C2 etj ...

Paragrafët që do të pasojnë do të diskutojnë këto rekomandime në lidhje me situatën në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Nivel lokal

Ndjekja e një qasje shumë aktive shumë-palëshe

Shumica e partnerëve raportojnë rezultate të mira nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë në nivel lokal. Komisioni e thekson fuqishëm këtë pikë në letrën e cituar më sipër. Kjo sfidë është trajtuar në Gjermani nga iniciativat e njohura ndërkombëtarisht si "Zinxhirët e arsimit" dhe formimi i "Agjencive për punësim të rinjve". Në kuadrin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, strategjia kombëtare për përfshirjen e fëmijëve romë në shkolla të zhvilluara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale nën dekadën e Strategjisë së përfshirjes së romëve (zgjatet deri në vitin 2020) qasja me shumë aktorë dhe shumë agjenci ndiqet gjatë gjithë fazës së zhvillimit të strategjisë. Gjegjësisht, agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare kanë marrë rol aktiv në dhënien e rezultateve të politikave për shumicën e aktorëve të ndikuar. Përveç kësaj, pranohet se ndërfaqet ndërmjet sistemit të mbështetjes së rinjve dhe sistemit të rregullt të arsimit dhe aftësimin për të rriturit kërkojnë vëmendje më të theksuar.

### **Zhvillimi i një plani të hapjes ndërkulturore në nivel komunal**

Shembulli i qytetit të Regensburgut (Gjermani), i cili u vizitua nga anëtarët e projektit, ku të gjitha përpjekjet u bashkuan konceptualisht në një "Koncept për Integrim" komunal, i cili përshkruan logjikën e masave përforcuese reciproke, vlerave dhe parimeve të përbashkëta të veprimit, si ndarja e aktiviteteve, inventarizimi i burimeve, qëllimet dhe masat. Planin duhet të paraqesë qartë filozofinë e përfshirjes në diversitet dhe të frymëzojë një diskutim në lidhje me një identitet të përbashkët në hapësirën e përbashkët të jetesës në kontrast me identitetin kombëtar, kulturor ose etnik. Bazuar në një ndjenjë të përbashkët të përkrahjes së masave të përbashkëta mund të zhvillohet dhe një qëndrim mikpritës për qytetarët e sapoardhur.



Inclusion of Roma and Migrants in Schools  
Trainings, Open Discussions  
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

## **Mbështetja e shkollave; ofrimi i burimeve shtesë (të planifikuara dhe të paparashikuara)**

Siç shprehet në konceptin e "tërrë shkollës", bashkitë dhe komunitetet lokale duhet të marrin përgjegjësinë për shkollat dhe shkollat duhet të mbështesin komunitetet, të pavarura nga përgjegjësia ligjore dhe skemat e financimit. Në kontekstin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, komunat marrin përgjegjësi për zbatimin e shkollave të integruara. Brenda kësaj përpjekje, komunat punojnë së bashku me aktorët vendorë dhe lokal në mbështetjen e shkollave drejt këtij synimi. OJQ-të, me përkrahje substanciale nga fondet ndërkombëtare, marrin drejtimin në punën me komunitetet lokale dhe komunat në identifikimin dhe mbështetjen e shkollave me nevojat e tyre në arritjen e integritimit më të mirë të grupeve të cënueshme në shkolla.

## **Mbështetja e vullnetarëve dhe inkurajimi i shoqërisë civile**

Komunitetet lulëzojnë nga aktiviteti vullnetar. Politikëbërësit mund të bëjnë shumë për të mbështetur dhe inkurajuar një angazhim të tillë. Aktiviteti vullnetar nga vetë politikëbërësit mund të jetë një shembull i qëndrimit të duhur qytetar. Inkurajimi dhe mbështetja për ekspozimin e nxënësve dhe studentëve në aktivitete vullnetare, pra në fushën e praktikave dhe veprimeve të përbashkëta vullnetare të klasave shkollore, studentëve, etj., mund të ndihmojnë për ta kthyer vullnetarizmin në një "sjellje standarde" të qytetarëve të mirë. Ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, vullnetarizmi po merr rol më të madh në përgjigje ndaj sfidave të integritimit të grupeve të cënueshme në sistemin e shkollave dhe pranimit të dallimeve kulturore në mënyrë të natyrshme. Përveç kësaj, hapja ndërkulturore e grupeve tradicionale vullnetare dhe shoqërore duhet të mbështetet nga qeveritë lokale, p.sh., duke e bërë financimin të varur nga hapja e tillë.

## **Rrjetëzimi i mësuesve, iniciativave, punëtorëve socialë dhe vullnetarëve për të mësuar nga njëri-tjetri**

Komunat gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të mësuesve, punonjësve socialë, nëpunësve publikë në të gjitha agjencitë, sikur edhe vullnetarët dhe studentët duke i inkurajuar, mbështetur dhe financuar skemat e shkëmbimit të përvojave, mbikëqyrjes së punës së ndërsjellë, punëtorive, informimit dhe trajnimit të përbashkët të mëtejshëm. Rrjeti ndërpersonal i aktorëve aktive dhe efektiv shpesh vjen nga aktivitete të tilla, krahas koordinimit më të mirë të aktiviteteve.

## **Nivel kombëtar**

### **Të gjitha politikat duhet të adresojnë situatën e përgjithshme sociale dhe mundësitë sociale**

Një situatë e qëndrueshme sociale, një jetesë e mjaftueshme dhe një infrastrukturë e mjaftueshme (strehimi, transporti) janë parakushte për suksesin arsimor. Prandaj, politikat kombëtare duhet të punojnë për të siguruar mundësi të mjaftueshme për jetesë dhe mundësi ekonomike për prindërit. Shkollat duhet të jenë vende të integritimit holistik, jo vetëm të arsimit. Në Gjermani, financimi, veçanërisht për arsimin fillor, është nën standardet e OECD. Rezultatet e mira nuk mund të priten nëse burimet janë të papërshtatshme për sfidat shumë më të mëdha.

### **Të gjitha politikat e arsimit duhet të bazohen në një kuptim mjaft kompleks të fakteve të një shoqërie migracioni**





Inclusion of Roma and Migrants in Schools  
Trainings, Open Discussions  
and Youth Volunteering Activities

<https://romigsc.eu>



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IP1-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

KE ka propozuar një koncept të qëndrueshëm të "përfshirjes nëpërmes diversitetit" brenda vlerave të përbashkëta të të drejtave individuale dhe demokracisë, në të cilën janë anëtarësuar të gjitha vendet anëtare. Ky koncept duhet të konsiderohet si i detyrueshëm dhe duhet të promovohet më gjerësisht në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Duhet të jetë baza e të gjithë trajnimit dhe edukimit për edukatorët dhe vullnetarët, si dhe agjentët e qeverisë. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ky koncept është miratuar dhe promovuar gjerësisht dhe shumica e sfidave në zbatim janë identifikuar. Sidoqoftë, vazhdon përpjekja ende e nevojshme për një zbatim më të mirë të konceptit.

### **Sigurimi i burimeve adekuate**

Të gjitha raportet e partnerëve në mënyrë unanime pohojnë se sistemi arsimor në tërësi është i nën-financuar kundrejt nevojave të identifikuara. Sistemi arsimor është i ngarkuar me shumë misione shumë më komplekse në situatën aktuale të diversitetit në rritje, ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike dhe revolucioneve teknologjike. Burimet duhet të zgjerohen shumë, duke filluar me arsimin e hershëm të fëmijërisë.

### **Inkurajimi i eksperimentimit dhe fleksibilitetit për të përballuar problemet e reja, përshtatja dhe zgjidhjet kryesore nga poshtë-lart. Krijimi i hapësirave arsimore transnacionale**

Zhvillimet në një shoqëri migruese janë komplekse dhe nganjëherë vështirë se mund të parashikohen. Prandaj, sistemet arsimore duhet të bëhen sistematikisht të adaptueshëm duke lejuar një numër të rrugëve dhe qasjeve arsimore.

Ata emigrantë që synojnë të kthehen në vendet e tyre të origjinës ose të vazhdojnë të emigrojnë në vende të tjera, si dhe qytetarët evropianë që ndryshojnë vendin e tyre të jetesës shumë herë gjatë karrierës së tyre, mund të mos hërbehen mirë nga arsimiti vetëm në nga gjuhët europiane më pak të përdorura. Ekzistojnë modele të "Shkollave Ndërkombëtare", të cilat aktualisht synojnë një audiencë të familjeve të ekspertëve të lëvizshëm, si dhe elita veçanërisht të orientuara globalisht, edhe atë për tarifa ndonjëherë të larta. Koncepti i arsimit transnacional duhet të vihet në dispozicion të audiencave më të gjera. Diploma dhe çertifikatat e pranuar ndërkombëtarisht duhet të zhvillohen dhe zbatohen. Sistemi arsimor i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë duhet të përpiqet të përmbushë standardet ndërkombëtare duke ofruar kompetenca të njohura ndërkombëtarisht. Kjo mund të çojë në hapjen e sistemit arsimor për përvojat transnacionale.

### **Zgjerimi i hulumtimeve dhe i eksperimentimit**

Ndërsa efektiviteti i pilot projekteve individuale, qofshin ato kombëtare apo ndërkombëtare, shpesh është dyshues, hulumtimi i bërë nga partnerët, si dhe deponimi i praktikave të mira të mbledhura (të cilat shpesh janë financuar nga programet "eksperimentuese") tregojnë se iniciativa të tilla dhe një depo të pasur të praktikave të mira që ilustronë efektivitetin e shumë prej rekomandimeve të dhëna nga KE. Zvogëlimi i fondeve për një eksperimentim të tillë, si dhe ato për qasjet dhe rezultatet e analizës, mund të rrisin më tej opsionet në dispozicion të politikëbërësve.



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation – Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

## **Investimi në edukimin e mësuesve dhe shkëmbimin ndërkombëtar, inkurajimi i perspektivës ndërkombëtare si parakusht për mësimdhënie kompetente**

Dijet për interkulturalitetin dhe diversitetin nuk mund ta zëvendësojnë të përjetuarit e tij. Raportet e partnerëve dhe diskutimet vërejnë se shumica e stafit mësimor në shkolla është shoqërisht mjaft homogjen dhe nga pjesa më e madhe e popullatës së zakonshme. Përvoja e rrallë aktuale me elementë të qëndrueshëm të diversitetit, si vullnetarizmi në ambiente të ndryshme sociale, eksperiencia jashtë vendit etj. Nuk janë një pjesë e detyrueshme e edukimit të mësuesve ose një kriter relevant përzgjedhës. Megjithatë, ka shumë elementë të cilët bëjnë të kuptohet se pikërisht kjo përvojë mund të ndërtojë kompetencat që mësuesit i kanë sot. Prandaj, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet të konsiderojë inkurajimin dhe planifikimin për përfshirjen e një përvoje të tillë në trajnimin fillestar dhe të mëtejshëm të mësuesve.

### **Përcaktimi i përshtatshëm i kompetencave të mësimdhënësve, theksimi i komunikimit, ndjeshmërisë, kompetencës socio-emocionale dhe përshtatjes**

Misioni i arsimit në ditët e sotme është më i gjerë sesa ndërtimi i njohurive apo edhe ndërtimi i karakterit individual. Shkollat duhet, sipas konceptit të "shkollës së tërë", të ndërtojnë ura për komunitetet dhe punëdhënësit, të ndërveprojnë me një sërë agentësh të tjerë, të edukojnë, komunikojnë dhe të ndërmjetësojnë. Profilët e kompetencave të mësuesve duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat.

### **Zgjerimi i përdorimit të medias digjitale në shkolla, investimi dhe inkurajimi i zhvillimit të medias digjitale në arsim**

Siç përmend KE, përdorimi i medias digjitale mund të rrisë mundësitë për arsimim miqësor të llojllojshëm. Siç ilustron raportet e vendeve partnere, larmia në rritje e nxënësve shtrin kufijtë e asaj që mund të bëhet nga mësuesit individualë për të rregulluar dhe përshtatur programet e trajnimit, p.sh., përdorimin dhe mirëmbajtjen e kompetencave në gjuhën amtare si dhe përdorimin e kësaj gjuhe për të ndërtuar njohuri të përgjithshme në lëndët si STEM mund të bëhet rrallë nga mësuesit e vendit nikoqir. Mediat digjitale mund të japin udhëzime në çdo kohë dhe në çdo vend. Prandaj ato janë një mjet i fuqishëm për të zbutur mangësitë dhe dilemat aktuale. Përkundër eksperimentimit individual, përdorimi i këtyre mediave dixhitale shumë gjuhësore është aktualisht larg praktikës së zakonshme në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Një përpjekje e bashkërenduar për të arritur njohjen e të nxënësve dhe rezultatet nëpërmjet përdorimit të medias digjitale mund të jetë një nxitje e fortë për një përdorim më të gjerë të mediave të tilla.

### **Praktikat më të mira**

Projekti ka dokumentuar më shumë se 60 praktika të mira në fushë, të cilat janë përshkruar dhe referuar në raportin e sintezës së projektit në disa detaje. Praktikat "më të mira" më poshtë janë identifikuar nga partneriteti si veçanërisht interesante.

- InMigraKids (GJERMANI): Koncept holistik për hapjen ndërkulturore të shkollave, duke punuar me prindërit, të ndihmuar nga një grup ndërmjetësish gjuhësor vullnetar nga më shumë se 30 gjuhë.



Erasmus+, KA3: Initiatives for policy innovation –  
Social inclusion through education, training and youth  
Project number: 580228-EPP-1-2018-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN  
3-year project: 31 December 2016–31 December 2019  
Project countries: Slovenia, Germany, Spain, Italy, FYR of Macedonia, Turkey

- Asistenti i Romëve (SLLOVENI): Ndërmjetësuesit e trajnuar nga komuniteti rom ndihmojnë fëmijët të kapërcejnë pengesat emocionale dhe gjuhësore para përfshirjes në kopshtin e fëmijëve dhe në shkollë dhe veprojnë si ndërlidhës midis kopshtit ose shkollës dhe komunitetit rom.
- Projekti i Kaktus (ITALI): Projekti zhvillon materiale dixhitale të të mësuarit dhe të teksteve në italisht të thjeshtuar në të gjitha lëndët në mënyrë që të ndihmojë nxënësit të kenë qasje në të mësuarit në të gjitha lëndët, ndërkohë që në të njëjtën kohë mësojnë gjuhën italiane nëpërmjet këtij materiali.
- Qendra e burimeve për Romët (IRRM) është OJQ shumë aktive që ofron shërbime të posaçme arsimore për popullatën rome në formë të mbështetjes së asistentëve lokalë, duke ofruar trajnime dhe advokime të posaçme. Misioni i saj është përmes mobilizimit të autoriteteve lokale dhe të gjithë strukturës shoqërore, të ndërlidhur për të arritur një integrim më të shpejtë dhe më të lehtë të komunitetit rom.